



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1647, datë 13.07.2011

Për

“Shqyrtimin e kërkesës së Albanian Mobile Communications sh.a., mbi zgjatjen e afatit fillestar të Kontratës Tip me pajtimtarin nga dymbëdhjetë muaj me njëzetë e katër muaj.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 13.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e kërkesës së Albanian Mobile Communications sh.a., mbi zgjatjen e afatit fillestar të Kontratës Tip me pajtimtarin nga dymbëdhjetë muaj me njëzetë e katër muaj.”

BAZA LIGJORE:

- Neni 99, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
- Neni 15, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Ligji nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (Ligj nr.9902);

- Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të ligjit nr. 9918,
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1264, datë 28.04. 2010, “Për Miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme” i ndryshuar;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit “Albanian Mobile Communications sh.a.” me nr. 1683/25 Prot., datë 17.05.2011, të depozituar në AKEP, me anë të së cilës ka paraqitur kërkesën me objekt: “ *Kërkesën së Albanian Mobile Communications sh.a., mbi zgjatjen e afatit fillestar të Kontratës Tip me pajtimtarin nga dymbëdhjetë më njëzetë e katër muaj.*”
- Projektvendimin mbi “Shqyrtimin e kërkesës së Albanian Mobile Communications sh.a., mbi zgjatjen e afatit fillestar të Kontratës Tip me pajtimtarin nga dymbëdhjetë muaj me njëzetë e katër muaj.”
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AMC sh.a., me anë të shkresës me nr. 1683/25 Prot., datë 17.05.2011, kërkon zgjatjen e afatit fillestar të Kontratës Tip me pajtimtarin, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1264, datë 28.04.2010, “Për Miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme” i ndryshuar, nga dymbëdhjetë muaj me njëzetë e katër muaj.

Gjithashtu, AMC sh.a argumenton se:

1.1 Shtyrja e afatit të kohëzgjatjes së kontratës Tip të pajtimit duhet të konsiderohet një benefit për klientin pasi për të do të mundësohet:

- a) Një tarifë mujore më e ulët si dhe kostot për klientin do të jetë edhe më të vogla;
- b) Aplikimi subvencioneve për терминалет (diskaunte e deri përfitim të pajisjeve celulare falas);
- c) Benefite të tjera si oferta, minuta free pa tarifim, tarifim off peack, etj.

1.2 Kjo kohëzgjatje e kontratës për abonime me subvencion aplikohet në vendet e rajonit të Ballkanit po ashtu edhe në Europë.

1.3 AMC në kërkesën e saj i referohet Direktivës së Bashkimit European 2009/136/EC mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, nenit 30 dhe pretendon se “*Shtete anëtare duhet të bëjnë të mundur që kontratat ndërmjet konsumatorëve dhe kompanive që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike nuk do të mund të lidhen për një periudhë fillestare angazhimi që të kalojë njëzet e katër (24) muaj*”.

Si përfundim, AMC sh.a. kërkon nga AKEP që :

- të rishikojë në një kohë sa më të shkurtër vendimin e tij për aprovimin e kërkesës së saj.

1.4 Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.1264, datë 28.04. 2010, ka miratuar “*Termet e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme*”. Ky vendim është ankimuar nga AMC duke atakuar disa pika të tij, ndër të tjera dhe Pikën 15.1.1- [*Nëse pajtimtari nuk ka njoftuar me shkrim AMC se nuk dëshiron vazhdimin e kontratës përtej afatit 2 (dy) muaj, kontrata kthehet në kontratë me afat të pacaktuar, por jo më shumë se 24 (njëzet e katër) muaj nga data e nënshkrimit të saj*].

1.5 Me VKD nr.1332, datë 15.07.2010, AKEP ka pranuar disa kërkesa të ankimimit të bërë dhe konkretisht për Pikën 15.1.1 duke e ndryshuar si më poshtë: “*Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës prej pajtimtarit. Nëse pajtimtari nuk ka njoftuar AMC sh.a. me shkrim ose në zyrat e saj, se nuk dëshiron vazhdimin e kontratës përtej afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj, kontrata kthehet në kontratë me afat të pacaktuar*”.

2. Këshilli Drejtues, në lidhje me sa ka kërkuar AMC sh.a , dhe argumenteve të saj, arsyeton si më poshtë:

2.1 AMC i referohet Direktivës së Bashkimit European 2009/136/EC, nenit 30/pika 5, përmbajtja e të cilit është si vijon: *Member States shall ensure that contracts concluded between consumers and undertakings providing electronic communications services do not mandate an initial commitment period that exceed 24 months. Member States shall also ensure that undertakings offer users the possibility to subscribe to a contract with a maximum duration of 12 months.*

2.2 Duke i'u referuar përmbajtjes si më lart, duhet të garantohet që kontrata e nënshkruar midis përdoruesve dhe sipërmarrësve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike nuk duhet të mandatojë një periudhë fillestare që i kalon 24 muaj. Gjithashu duhet të sigurohet që sipërmarrësit duhet t'ju ofrojnë përdoruesve mundësinë e nënshkrimit të një kontrate me një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh. Pra, ofruesit janë të detyruar të ofrojnë afatin fillestar prej 12 muajsh dhe nëse ofrohet ndryshe ky afat nuk duhet t'i kalojë 24 muajt.

2.3 Sa më sipër, me qëllimin e mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, dhe bazuar në objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gërmat 'b' dhe 'ë', pika 3, neni 7 i Ligjit nr. 9918, datë 17.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", AKEP, konstaton se kërkesa e AMC është pjesërisht e drejtë dhe e bazuar,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë kërkesën e paraqitur nga Albanian Mobile Communications sh.a., dhe bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 15 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e sipërmarrësit "Albanian Mobile Communications sh.a.", mbi zgjatjen e afatit fillestar të "Kontratës Tip me Pajtimtarin" nga dymbëdhjetë me njëzetë e katër muaj.
2. Të ndryshojë "Kontratën Tip me Pajtimtarin" të AMC sh.a., të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1264, datë 28.04.2010, (i ndryshuar me VKD nr. 1332, datë 15.07.2010, i ndryshuar me VKD nr. 1370, 01.09.2010), si më poshtë:

15. Kohëzgjatja e kontratës

15.1 Kjo kontratë lidhet për një afat fillestar të përcaktuar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës prej pajtimtarit.

15.2 Në rast se AMC-ja do të ofrojë për Pajtimtarët shërbime të tjera, apo programe tarifore/oferta specifike të tilla të cilat do të kenë si element të domosdoshëm të tyre detyrimin për të përdorur shërbimet për një periudhë të caktuar, atëherë rregullat e parashikuara nga këto kushte të përgjithshme do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me kushtet e veçanta që do të jenë karakteristike e marrëdhënies së posaçme midis AMC-së dhe Pajtimtarit. Afati fillestar i kontratave të tilla nuk duhet të jetë më shumë se 24 muaj.

16. Zgjidhja e Kontratës

16.2 Pas kalimit të afatit fillestar, pajtimtari mund t'a zgjidhë kontratën duke njoftuar me shkrim AMC-në për këtë ose me deklaram në dyqanet e AMC. AMC-ja do t'a zgjidhë kontratën në fund të muajit në vazhdim, por asnjëherë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga ana e AMC-së . Në rast se kontrata zgjidhet gjatë muajit, tarifa mujore e pajtimit do të paguhet deri në fund të muajit kalendarik gjatë të cilit është zgjidhur kontrata.

3. Albanian Mobile Communications sh.a., të pasqyrojë ndryshimet në Kontratatën Tip me Pajtimtarin (ekzistuese), sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Të njoftohet AMC sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

KRYETARI
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**